

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot në datë 20.06.2025, lidhet kjo kontratë dhurimi kuotash ndërmjet palëve të mëposhtme:

PALA DHURUESE : Remir Gjolligaj, shtetas Shqiptar, lindur me 22.02.1987, ne Fier, banues ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjofimit me numer personal I70222094T, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar, ortak i shoqërisë e shoqërisë "AVIOMI" sh.p.k (Kodi NUIS M32028018A), që merr pjesë në shoqëri me 100 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë .

PALA PRANUESE E DHURIMIT : Odeas Kuqi, shtetas Shqiptar, lindur me 28.04.1999, ne Tirane, banues ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjofimit me numer personal J90428037R, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

OBJEKTI I KONTRATËS: Dhurimin e 1 kuote e barazvlefshme me 100 % të kapitalit që dhuruesi zotëron në shoqërinë "AVIOMI" sh.p.k (Kodi NUIS M32028018A)

BAZA LIGJORE: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (neni 705 e vijues), Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Statuti i shoqërisë "AVIOMI" shpk

Nga deklaratimet e palëve të mësipërme dhe nga dokumentet e paraqitura rrjedh se:

- a) **Z.Remir Gjolligaj** është ortak i vetem 100 % të shoqërisë "AVIOMI" sh.p.k, me seli Tirane, Rruga "Muhamet Gjolllesha", Njesia me Nr.Pasurie 1/357 -N13/2, Zona kadastrale 8270, prane Stadiumit Dinamo, e regjistruar pranë QKB (Qendrës Kombëtare të Biznesit), me kapital të shoqërisë prej 1,000,000 (nje milion) lekë. Në këtë kapital ai zotëron 1 (një) pjesë dhe 100 (njëqind) % të kapitalit të shoqërisë;
- b) **Z. Remir Gjolligaj** deklaron se 1 kuotë të tij në shoqëri (e që përbëjnë një pjesë dhe 100 % të kapitalit të shoqërisë) ai ka ndër mend t'ia dhuroje z. Odeas Kuqi;
- c) **Z. Odeas Kuqi** ka shprehur dëshirën e tij dhe pranon dhurimin e kuotave;
- d) Ky veprim i dhurimit të kuotave është miratuar nga asambleja e ortakëve të shoqërisë me vendimin përkatës.

DEKLARIME DHE GARANCI : Pala shitesë deklaron dhe garanton pranuesen e dhurimit se:

- Dhuruesi deklaron dhe garanton pranuesin e dhurimit se pjesët (kuotat) e kalipalit të shoqërisë objekt i kësaj kontrate janë të transferueshme dhe të lira nga cdo barrë hipoteke, apo cdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- Ne cilesine e ortakut te shoqërisë "AVIOMI" shpk nuk ka shitur, dhuruar, premtuar per shitje, dhene si garanci apo ne cdo lloj forme tjetër te kete disponuar mbi pjese te kuotes se kapitalit apo asetëve te shoqërisë.

- Ne cilesine e ortakut te shoqërisë garanton se pranuesen e dhurimit se shoqëria., nuk ka asnje borxh ndaj insitucione shteterore si taksa, tatime, apo pale te treta private perfshire Bankat qe mund te coje ne uljen e vleres se kuotes se dhuruar .

- Pala Dhuruese deklaron se me nenshkrimin e kesaj marreveshjeje nuk ka asnje pretendim te tanishem apo te mevonshem te asnje lloji per dhurimin te kuotes duke e konsideruar ate te drejte dhe te sakte.

Pala pranuese e dhurimit deklaron dhe garanton dhuruesin se:



- Nuk ka asnje pengese per lidhjen e kesaj kontrate dhurimi .

Sot ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, të dy palët deklarojnë se **z.Remir Gjoligaj** dhuron pa asnje kundershperblim dhe **z.Odeas Kuqi** pranon dhurimin nga z.Remir Gjoligaj të 1 kuotë e barazvlefshme me 100 % të kapitalit në shoqëri e që deri tani i zotëronte **z. Remir Gjoligaj** .

Z. Odeas Kuqi deklaron se eshte njohur me aktet e shoqërisë dhe me gjendjen ekonomike e financiare të saj dhe deklarojne se si ortakë të shoqërisë përgjigjet sipas ligjit për të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve lidhur me këtë kalim pronësie, përfshirë dhe detyrimet e mëparshme.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhurimi, Pala Dhuruese **z. Remir Gjoligaj** e humbet 100 % mbi ato kuota që dhuroi në kapitalin e shoqërisë "AVIOMI " sh.p.k. dhe zotërues i 100 % të tyre bëhet **z Odeas Kuqi** me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ky kalim pronësie.

Kuotat dhurohen dhe zotërohen nga pranuesi i dhurimit që nga data e sotme.

Pas këtij akti dhurimi kuotash, shoqëria e lartpërmendur ka 1 (nje) ortak dhe pikërisht:

1. **Z. Odeas Kuqi**, që në kapitalin e shoqërisë zotëron 1 (një) pjesë dhe 100 (njqind) % të kapitalit të shoqërisë me vlere 1,000,000 (nje milion) Lek

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE :Palët bien dakord që cdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi dhe ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes palëve. Në rast se bisedimet nuk japin rezultat atëherë konflikti do të zgjidhet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, Shqipëri.

HYRJA NE FUQI :Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Kontrata përpilohet në 2 kopje të njëjta në gjuhën shqipe me vleret te njejte ligjore dhe pasi lexohet nga palet dhe pasi u gjendet ne përputhje te plote me vullnetin e paleve kontraktuese nënshkruhet rregullisht prej tyre personalisht sipas ligjit.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

Remir Gjoligaj



PALA PRANUESE E DHURIMIT

Odeas Kuqi

